

Data 14.04.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Rikonstruksioni i hapësirës teknike në bodrumin e Kryeministrisë (përforsim strukturor dhe ndërtim i depos së ujit) dhe rikonstruksioni dhe instalimi i pajisjeve per Arkiven e Kryeministrisë.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 71,205,446.92 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit te lartë monetar dhe te ulet monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b" të Ligjit nr. 1009/2009: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël."

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes

- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirin e lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P - 1.	A	Punime germimi ne toke
N.P - 2.	A	Ndertime civile dhe industriale
N.P - 3.	A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje Fasada
N.P - 4.	A	Rruge , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista Aeroportuale
N.P - 7.	A	Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
N.P - 11.	A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
N.P - 12.	A	Punime te inxhinerise se mjedisit.

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S – 1	A	Punime per prishjen e ndertimeve
NS - 2	A	Impiante-hidrosanitare, Kuzhina, Lavanteri, mirembajtja e tyre.
N.S – 4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
N.S - 6	A	Sinjalistike rrugore jondricuese
N.S - 12	A	Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit.
N.S - 13	A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
N.S – 14	A	Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret

dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategorite jane kerkuar bazuar ne zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshte:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P- 1 A	Punime germimi ne toke	<ul style="list-style-type: none"> - Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto 	0-20 mln leke	143,512.50 leke
N.P- 2 A	Ndertime civile dhe industriale.	<ul style="list-style-type: none"> - Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F.v Mur gipsi me dopio konstruksion, EI120 (dopio pllake gipsi "firebond" ose "fireline" + CW100 + lesh guri 40kg/m3 + CW100 + dopio pllake gipsi "firebond" ose "fireline"), perfshire fleten e llamarines ne mes. - F.V Shtrese betoni C30/37 - Shtrese me pllaka grez importi, 90x90cm - Perforcim i mureve mbajtes me kemishim 4 cm, me beton C30/37 > - Mbjellje hekur betoni periodik Ø 10mm me rezine epokside bikomponente ne beton, te pershtatshme per lidhje me kohezion te permiresuar nen veprim sizmik > 	0-20 mln leke	14,444,408.87 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Mbjellje hekur betoni periodik Ø 10mm me rezine epokside bikomponente ne mure mbajtes, te pershtatshme per lidhje me kohezion te permiresuar nen veprim sizmik > - Beton i projektuar C35/45 > - Pastrim i shufrave te hekurit > - Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 - F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm - F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm - Soleta te plota b/a C 30/37 > - Kollona b/a monolite C 30/70 h ~ 4m > - Mure b/a C 30/37 - Trare e arkitrare b/a C 30/37 > 			
N.P-3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada,	<ul style="list-style-type: none"> - Patinim tavani me stuko - Patinim muri me stuko - Veshje me pllaka 	0-20 leke	mln	570,487.98 leke
N.P-4 A	Rruge , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista Aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me cakell pas mureve - Shtrese çakelli t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese rere natyrore t=10cm 	0-20 leke	mln	569,364.27 leke
N.P-7 A	Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> - Spostim linjash hidraulike > - Tub FFP DN 200 mm PN 16 bar L = 80 cm (Puddle flange pipe) - Tub FFG DN 100 mm PN 16 bar L = 100 cm > - Tub FFG DN 100 mm PN 16 bar L = 80 cm > - Tub FFP DN 100 mm PN 16 bar L = 80 cm (Puddle flange pipe) > - Tub FG DN 100 mm PN 16 bar L = 60 cm (Puddle flange pipe me një flanxhë lidhëse) > - Tub FFG DN 100 mm PN 16 bar L = 40 cm > - Tub FFG DN 65 mm PN 16 bar L = 100 cm > - Tub FFP DN 65 mm PN 16 bar L = 80 cm (Puddle flange pipe) > 	0-20 leke	mln	3,535,935.31 leke

		<ul style="list-style-type: none"> - Tub FFG DN 65 mm PN 16 bar L = 70 cm > - Tub FFG DN 65 mm PN 16 bar L = 30 cm > - Tub FFP DN 50 mm PN 16 bar L = 80 cm (Puddle flange pipe) - Tub FFG DN 50 mm PN 16 bar L = 50 cm - Tub FFG DN 50 mm PN 16 bar L = 40 cm > - Bërryl Q GS FF DN 100 mm PN 16 bar- 90° > - Bërryl GS FF DN 100 mm PN 16 bar 45° > - Bërryl Q GS FF DN 80 mm PN 16 bar 90° > - Bërryl Q GS FF DN 65 mm PN 16 bar 90° > - Bërryl Q GS FF DN 50 mm PN 16 bar 90° > - Ti FFG DN 100 x 100 x 100 mm PN 16 bar > - Ti FFG DN 80 x 65 x 80 mm PN 16 bar > - Reduktor FFR DN 100 x 80 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Reduktor FFR DN 80 x 65 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Nyje Çmontuese PAF GS FF DN 100 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Nyje Çmontuese PAF GS FF DN 80 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Nyje Çmontuese PAF GS FF DN 65 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Nyje Çmontuese PAF GS FF DN 50 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Flanxhë adaptor FF DN 100 mm PN 10 bar > - Flanxhë adaptor FF DN 50 mm PN 10 bar > - Saraçineskë GS FF tip portë DN 100 mm L = 30 cm, PN 16 bar > - Saraçineskë GS FF tip portë DN 80 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Saraçineskë GS FF tip portë DN 65 mm L = 20 cm, PN 16 bar > - Saraçineskë GS FF tip portë DN 50 mm L = 25 cm, PN 16 bar > - Galexhant mekanik FF DN 65 mm PN 16 bar > - Kosh thithjeje GS FF DN 65 mm PN 10 bar L = 20 		
--	--	--	--	--

		<p>cm tek linjat e thithjes nga pompat ></p> <ul style="list-style-type: none"> - Hinkë GS FF DN 200 mm PN 10 bar e shkarkimit të ujit tek tepërplotësi (bellmouth) > - Antivortex FF tek tubi i thithjes së pompave MNZ FF DN 100 mm PN 16 bar > - V. Grup Presioni me 3 pompa elektrike për sistemin e furnizimit me ujë për ujitjen > - V. Grup Presioni me 3 pompa elektrike për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm > - V. Grup Presioni i sistemit MNZ, 1 pompë elektrike, 1 pompë diesel dhe 1 pompë pilot > - V. Pompë drenazhi $q = 15 \text{ m}^3/\text{orë}$, $H = 20 \text{ m}$ > - Kundravalvol tip Flap Valve tek tubi i shkarkimit DN 200 mm PN 10 bar > - F.V Tubacione polietileni PE100 (MRS 10), PN 16, me karakteristika ne perputhje me normat UNI EN 12201 dhe ISO 4427, perfshire manikotat me elektrosaldim dhe rakorderite - permase OD 140mm - F.V Tubacione polietileni PE100 (MRS 10), PN 16, me karakteristika ne perputhje me normat UNI EN 12201 dhe ISO 4427 > - F.V Tubacione polietileni PE100 (MRS 10), PN 16, me karakteristika ne perputhje me normat UNI EN 12201 dhe ISO 4427 > - F.V Hidrant i jashtem nentoke DN80, me nje dalje, shkarkim automatik i ujit per kunderngritjes, ne perputhje me EN 14339, flaxhe PN16 ne perputhje me EN1092-2. > - F.V Saracineske per vendosje nentoke, e flanxhuar, PN 16, me tregim te hapjes sipas UNI 11443, permase OD 140mm, > - F.V Saracineske per vendosje nentoke, e flanxhuar, PN 16, me tregim te hapjes sipas UNI 11443 > - F.V Lidhje per brigadat PNMZSH, se bashku me kutine prej llamarine celiku te lyer RAL3000, 3" me n°2 lidhje DN70 sipas UNI 10779 > - Flanxhë adaptor FF DN 65 mm PN 10 bar > 		
N.P-11 A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Priza shuko universal - F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm - F.V. Kuti suport pllaket 4 mod 	0-20 mln leke	2,616,364.08 leke

dhe shpërndarjen e energjisë		<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Çeles 2 polar 220V 10A - F.V. Ndricules tip plafoniere, emergjence, 1x18w, IP65 - Montim Gjenerator Aerosol per shuarjen e zjarrit, per volum deri 50m3 - Montim Gjenerator Aerosol per shuarjen e zjarrit, per volum deri 30m3 - Modul i aktivizimit te gjeneratoreve Aerosol - Pike komandimi manuale me celes (per c'aktivizim manual) - Pike komandimi manuale me buton (per aktivizim manual) - Pike furnizim fuqie per aktivizimin e gjeneratoreve "Aerosol" - Rele 12/24V - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 5x16 mm² (linja furnizimit), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 5x6 mm² (linja AHU), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 3x4 mm² (linjat e kondicionerëve), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 3x2.5 mm² (linjat rafteve & rack-ut), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Përcjellës Cu tip FG17 0.6/1 kV, 1x2,5 mm² (linjat e prizave), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 3x1,5 mm² (linjat e ndriçuesëve), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Tub i fortë (RIGID) Ø 20 mm, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, grapeta, upa vida, bashkuese, brryla, rakoderi etj - F.V. Panel Elektrik Arkiva [P.E.A] jashtë murit i 		
------------------------------	--	--	--	--

		<p>prodhuar dhe verifikuar sipas skemës së projektit dhe konform IEC 61439-1/-3, IEC 60364, i pajisur me të gjithë aksesorët e montimit, etiketime, dokumentacion teknik dhe certifikatë konformiteti. Përfshihet testimi dhe raporti i protokollit nga ndërt</p> <ul style="list-style-type: none"> - F.V. Panel Elektrik UPS [P.E.S] jashtë murit i prodhuar dhe verifikuar sipas skemës së projektit dhe konform IEC 61439-1/-3, IEC 60364, i pajisur me të gjithë aksesorët e montimit, etiketime, dokumentacion teknik dhe certifikatë konformiteti. Përfshihet testimi dhe raporti i protokollit nga ndërtues - V. Ndrives LED me trup alumini të anodizuar, 44W - Dalje prizash > - Dalje celesash - Spostim linjash elektrike > - F.V. Kuti shpërndarëse jashtë murit > - F.V. Priza shuko universal jashtë murit IP65 > - F.V. Çeles 2 polar 220V 10A >> - F.V. Ndrives LED linear jashtë murit, 45W, IP65 > - F.V. Kabëll Cu tip FG17 0.6/1 kV, 4x50+1x25 mm² (linja furnizimit të pompës MNZ), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës >> - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 5x2.5 mm² (furnizimi i pompave të ujit në depo), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës >> - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 3x2.5 mm² (furnizimi i prizave të shërbimit në depo), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës >> - F.V. Kabëll Cu tip FG16OM16 0.6/1 kV, 3x1.5 mm² (linjat e ndrivesëve), së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Udhëzues kabllor >> - F.V. Eelektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm > - F.V. Kanaline metalike > 		
--	--	---	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur > - F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 > - F.V. Spostimi dhe sistemi i kanalave dhe kablove elektrike në ambjentin ekzistues të depove të ujit > 			
N.P-12 A	Punime te inxhinerise se mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km - Mbjellje me bar > - Depozitim materiali te germuar ne landfill > 	0-20 leke	mln	1,431,379.64 leke
N.S-1. A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Heqje dyer ekzistuese - Heqje vetrate duralumini ekzistuese - Heqje pllaka dyshemeje - Heqje tavan i varur me kartonxhes - Prishje shtresa betony - Prishje suvatim muri i brendshem - Prishje suvatim solete (h<4m) - Prishje mur tulle me pastrim - Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese - Prishje shtresa dhe pllaka ekzistuese > 	0-20 leke	mln	1,113,020.83 leke
N.S-2. A	Impiante-hidrosanitare, Kuzhina, Lavanteri, mirembajtja e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> - Damfer kundra zjarri 700x250 mm - Montim Shuares zjarri portatel, me pluhur 6kg, me aftesi shuarse jo me te ulet se 34A - 233BC - Montim Shuares zjarri portatel, me CO2, 5kg, klasa113B - Paneli i komandimit te impjantit te mbrojtjes nga zjarri - Modul per lidhjen ne LAN te paneli i komandimit te impjantit te mbrojtjes nga zjarri - F.V Hidrant i jashtem nentoke DN80, me nje dalje, shkarkim automatik i ujit per kunderngritjes, ne perputhje me EN 14339, flanaxhe PN16 ne perputhje me EN1092-2. > 	0-20 leke	mln	609,228.32 leke
N.S-4. A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Dyer metalike llamarine - Boje hidroplastike cilesi e larte - F.V Vetrates d/alumini me profil termik, xhami i poshtem 6 mm termik, 18 mm mbushje me gaz 	0-20 leke	mln	10,949,568.35 leke

	druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	<p>argon, xhami i brendshem 3+3</p> <ul style="list-style-type: none"> - F.v Dyer te blinduara - F.V Tavan i varur me pllake gipsi diamant, antizjarr - Shtrese stirobetoni - Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm - Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe - Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 - Plintuse grez h = 10 cm - Boje hidroplastike cilesi e larte - Shtrese industriale me beton me fibra celiku, e trajtuar me kuarç dhe me helikopter, t= 10 cm > - Shtrim me rezine stopox me ngjyra - F.V dyer te brendshme > - Veshje me kartonxhes aquapanel per fshehjen e tubacioneve > - Dyer te blinduara me akses kontroll > - Shtrese betoni C 12/15 - Nenshtrese zhavori - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama - Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm - Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah - Suvatim me llac cim M 25, 50, ne mure betoni - Membrane hidroizoluese Volgrip(nen pllaken e themelit dhe muret e jashtme te depos) > - Termoizolim solete me polisterol kompakt > - Patinim ose lyerje me rezine teknologjike epoxy > 		
N.S-6. A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	<ul style="list-style-type: none"> - Sinjalistike me ndricim "STOP" per paralajmerim hyrje ne nje ambient ne fazen e shurjes se zjarrit 24V - Drite paralajmeruese per rrenje zjarri, me pulsime, 24V 	0-20 mln leke	30,915.41 leke
N.S-12. A	Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimi t.	<ul style="list-style-type: none"> - Tubacione bakri linjat gaz/leng ftohes, i termoizoluar, 9.5 mm, bashke me sistemin e mberthimit. - Tubacione bakri linjat gaz/leng ftohes, i termoizoluar, 19.1 mm, bashke me sistemin e 	0-20 mln leke	1,854,038.73 leke

		<p>mberthimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Montim Paisje e jashme mini - VRF, "POMPE NXEHTESIE" 22.50 kW Ftohje, perfshire mbeshteteset antivibrante, sistemin e mberthimit dhe te fiksimit si dhe komanden qendrore remote te saj bashke me kabllimin e kontrollit. - Montim Paisje e jashme mini - VRF, "POMPE NXEHTESIE" 15.50 kW Ngrohje, perfshire mbeshteteset antivibrante, sistemin e mberthimit dhe te fiksimit si dhe komanden qendrore remote te saj bashke me kabllimin e kontrollit. - Montim AHU Njesi e trajtimit te ajrit, me karakteristika: • Ventilatori i dergimit inverter: 3 000m³/h, Extrenal pressure 100 Pa; • Ventilatori i kthimit inverter: 3 000 m³/h, Extrenal pressure 100 Pa; Bateri ftohje me DX Coil 22.5 kW; • Bateri ngrohje me DX Coil 15.5 kW; etj. - Tubacione dhenje dhe thithje ajri, panel sandwich, prej shkume poliuretani te zgjeruar, te veshur me flete alumini nga te dyja anet brenda/jashte me spesor 80/120 mikron, bashke me aksesoret e prodhimit, perforcuese etj. - Xhunto antivibrante per lidhjen e paisjeve me kanalet e ajrit - Grile thithje ajri, sasia e ajrit, se bashku me plenum dhe damper perkates 1500 m³/h - Grile thithje ajri, sasia e ajrit, se bashku me plenum dhe damper perkates 150 - 300 m³/h - Difuzor swirl dhenje ajri, sasia e ajrit 500 m³/h - Grile shiu prej alumini te anodizuar, sasia e ajrit 3.000m³/h - Tubacione fleksibel te termoizoluar dhenje/thithje ajri φ200 mm - Montim Ventilator linje per largimin e tymrave, temperature deri ne 400°C, sasia e ajrit 1950m³/h - Grile shiu prej alumini te anodizuar, sasia e ajrit 1950 m³/h - F.V Modul ASD, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës. Përfshirë konfigurimin dhe testim komisionimin - F.V Central dedektimi zjarri i kompletuar, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës. 		
--	--	---	--	--

		<p>Përfshire konfigurimin dhe testim komisionimin</p> <ul style="list-style-type: none"> - F.V Modul komunikimi në loop me 8 hyrje dhe 2 dalje, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës. Përfshire konfigurimin dhe testim komisionimin - F.V Sensor multifunksional, tymi, nxehtësie, Co, bashkë me bazë dhe me izolator të inkorporuar, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës. Përfshirë konfigurimin dhe testim komisionimin - F.V Tub për aspirimin që lidhet me ASD, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës. Përfshirë konfigurimin dhe testim komisionimin - F.V Kabëll për sistemin e dedektimit të zjarrit 2x0,8 mm² me skermo sipas EN20500, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - Montim Ventilator linje per largimin e tymrave, temperature deri ne 400°C, sasia e ajrit 300m³/h - Grile shiu prej alumini te anodizuar, sasia e ajrit 300 m³/h - Hapje vrimash ne mur me freze per kalimin e tubave te kondicionimit > - F.V. Tub i fortë (RIGID) Ø 20 mm, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, grapeta, upa vida, bashkuese, brryla, rakoderi etj >> - F.V Sensor multifunksional, tymi, nxehtësie, Co, bashkë me bazë dhe me izolator të inkorporuar, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm > - F.V Pulsant manual i adresueshëm me opsjon reset, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim > - F.V Kabëll për sistemin e dedektimit të zjarrit 2x0,8 mm² me skermo sipas EN20500, së bashku me të gjithë aksesorët > - F.V. Tub i fortë (RIGID) Ø 20 mm, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, grapeta, upa vida, bashkuese, brryla, rakoderi etj >> - F.V Sensor multifunksional, tymi, nxehtësie, Co, bashkë me bazë dhe me izolator të inkorporuar, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm > 		
--	--	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> - F.V Pulsant manual i adresueshëm me opsion reset, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim > - F.V Kabëll për sistemin e dedektimit të zjarrit 2x0,8 mm2 me skermo sipas EN20500, së bashku me të gjithë aksesoret > 		
N.S-13. A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.	<ul style="list-style-type: none"> - Sirene konvencionale 105bD/24V - F.V. Kabëll S/FTP Cat 7, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kabëll FTP Cat 5e, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Prizë Data RJ45 FTP Cat 7, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Prizë Data RJ45 FTP Cat 5e, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Rack 24U i kompletuar, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. PatchPanel Cat 7, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Switch për rrjetin e komunikimit 16 porta + 2 sfp, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. PatchPanel fibër optike, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Switch për rrjetin e komunikimit 8 porta + 2 sfp PoE+, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Sensor temperature & lagështie, dalje 4-20mA/0-10V/Modbus, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Kontroller për lidhjen e dy sensorëve dhe lidhjen me centralin e alarmit të zjarrit për të dhëne informacion mbi gjendjen, së bashku me të gjithë aksesoret e nevojshëm për montim, përfshirë 	0-20 mln leke	477,738.74 leke

		<p>etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës</p> <ul style="list-style-type: none"> - F.V. Kabëll i skermuar për trasmetimin e sinjalit analoog dhe ushqimit të sensorëve, Li2YCY 2x2x0.5 mm², së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - F.V. Sistem akses kontrolli për dyert, i përshtatshëm me sistemin aktual të aksesit. Përfshirë kontrollerrat, lexuesit e kartave, magnetet e dyerve, kontaktet, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës 		
N.S-14. A	Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	<ul style="list-style-type: none"> - F.V. Udhëzues kabllosh - F.V. Tapa për mbushje, seria e thjeshtë - F.V. Kutit, suport, pllakë, 3 module - V. Ndrigues LED me trup alumini të anodizuar, 44W - V. UPS 10 kVA, hyrje tre fazore, dalje një fazore, 3:1 - V. UPS për montim në Rack, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - V. Kamera tip dome 5 MP, Lente varifokale PoE, së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për montim, përfshirë etiketime dhe aksesore të tjerë ndihmës - Integrim i sistemeve të reja për Arkivën me sistemet ekzistuese të kryeministrisë 	0-20 mln leke	39,335.42 leke
N.S-18. A	Punime topogjeodezike	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik 		

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues teknik të punësuar dhe regjistruar si më poshtë::

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) inxhinier Elektrik
- 1 (nje) inxhinier Topograf

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6/c te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin e zbatimit, specififikimet teknike, raportet teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Inxhinier Ndërtimi	<ul style="list-style-type: none"> - Punime dyer dhe dritare - Punime shtresash - Punime tavani dhe suvatimi - Punime bojatisje - Punime murature tulle - Punime prishje - Punime hekur betoni
Inxhinier Hidroteknik	<ul style="list-style-type: none"> - Punime hidroteknike tek depo e ujit (Analiza jashte liste)
Inxhinier Mekanik	<ul style="list-style-type: none"> - Punime te ngrohjes dhe sistemit te kondicionimit (Analiza jashte liste)

Inxhinier Mjedisi	- Punime te prishjes, te transportit dhe mobilimit urban
Inxhinier Elektrik	- Instalime per ndricim - Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje - Analiza jashte liste
Inxhinier Topograf	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik. (Matjet topografike per ndertimin e Depos se ujit dhe mobilimit urban)

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat e mësipërme mbështen në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet te jete ne kantier per minimimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 punonjes për periudhën, tremujore nga data e zhvillimit te procedures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39 pika 6/ç te VKM nr.285/2021 “Per rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Numri i punonjësve është percaktuar bazuar tek faktorët si, volumet dhe kategoritë e punimeve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e këtij kriteri, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim."

Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të cmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhte:

Total ore pune= 26,675.62 ore

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 26,675.62 ore/8 ore= 3,334.57 dite pune

Dite pune gjithesej= 6 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 dite/muaj= 132 dite pune

Numri i fuqisë punëtore = 3,334.57 dite/132 dite= 25.26 puntore afersisht 25 puntore

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është min 25.26 puntore. Pranojmë 25 puntore

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi, ose qira, ose kontrate furnizimi.

Mjetet	Sasia	Statusi
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton	1 cope	në pronësi ose me qera
Kamioncine deri ne 6 tone	1 cope	në pronësi ose me qera
Minieskavatore	1 cope	në pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	në pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	në pronësi ose me qera
Auto-Pompe betoni	1 copë	në pronësi ose me qera
Mjet Autovinç	1 cope	në pronësi ose me qera
Kompresor	1 cope	në pronësi ose me qera
Matrapik	1cope	në pronësi ose me qera
Skeleri	150 m2	në pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	në pronësi ose me qera
Vibrator thellesie	1 cope	në pronësi ose me qera
Elektrosaldatrice	1 cope	në pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet te jene te angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- a) Për mjetet ne pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikaten e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pageses per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës përkatëse. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE

Mjetet	Sasia	Proceset e punes
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	1 cope	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto
Kamioncine deri në 6 tone	1 cope	Furnizim me materiale në objekt
Minieskavatore	1 cope	Ngarkim mbeturinash të dala nga prishjet
Autobot uji	1 cope	Punime për shtresa dhe rifiniture
Autobetoniere	1 cope	Transport betoni nga nyja e prodhimit deri në objekt (Punime betoni e beton armeje)
Auto-Pompe betoni	1 cope	Hedhja e betonit në objekt (Punime betoni e beton armeje)
Mjet Autovinç	1 copë	Furnizim me materialet e ndërtimit brenda në objekt
Kompresor	1 copë	Punime betoni e betonarmeje
Matrapik	1 cope	Montime të ndryshme në objekt
Skeleri	150 m ²	Skele metalike me tubo tavani ~ 4m Skele metalike me tubo fasade > 12m
Gjenerator	1 copë	Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik
Vibrator thellesie	1 cope	Vibrimin e shtresave të betonit
Elektrosaldatriçe	1 copë	Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH, etj., mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurrohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit nr. 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Projekti zbatimit, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe jane pjese e DST.

Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|--|----------|
| 1. Çmimi | pikët 70 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shitesë | pikët 5 |

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

- | | |
|--|----------|
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve
(jo më pak se 2 vjet) | pikët 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët 10 |
| 5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)
(jo më pak se 3 %) | pikët 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 70] pikë

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –5 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

- Punime ndërtimi dhe/ose rikonstruksioni në ndërtesa me funksion institucional dhe/ose administrativ, përfshirë punime ndërtimore dhe instalime teknike, me sipërfaqe jo më pak se 794.9 m², për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.

*Përlllogaritja e volumit specifik do të kryhet në varesi në kohezgjatjes së kontratës (data e fillimit të punimeve-data e përfundimit të punimeve) pavarësisht periudhës brenda së cilës janë realizuar këto volume specifike.

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 5 vjeçar. Kriteri është vendosur për

të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudimit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe çdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perlllogartje.

Argumentim: “Punime ndërtimi dhe/ose rikonstruksioni në ndërtesa me funksion institucional dhe/ose administrativ, përfshirë punime ndërtimore dhe instalime teknike, me sipërfaqe jo më pak se 794.9 m², për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.”

“Kërkesa për realizimin e punimeve të ndërtimit dhe/ose rikonstruksionit në ndërtesa me funksion institucional dhe/ose administrativ, përfshirë punime ndërtimore dhe instalime teknike, bazohet drejtpërdrejt në natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit. Kjo kërkesë synon të garantojë se operatori ekonomik disponon përvojë të mjaftueshme në realizimin e punimeve të integruara ndërtimore dhe teknologjike, si dhe aftësi për të menaxhuar ndërhyrje në ndërtesa ekzistuese dhe zbatimin e instalimeve teknike, në përputhje me standardet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë.

Përcaktimi i sipërfaqes minimale prej 794.9 m² garanton që operatori ekonomik ka realizuar punime me volum dhe shtrirje të krahasueshme, ndërsa kërkesa për kontrata të përfunduara gjatë pesë viteve të fundit siguron verifikimin e kapacitetit aktual teknik dhe organizativ, në përputhje me standardet bashkëkohore të ndërtimit dhe aftësinë për realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara.”

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 18 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.5.

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

**5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)
[0 - 5 pikë]**

Argumentimi: Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, perfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë per përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndesisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike ne masen jo me pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve te VKM nr. 216 date 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur ne vlerë, në këtë rast **jo më pak se 1,187,174.18 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit te sigurise ne kantieret e perkoheshme e te levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do te konsiderohet vlere e ofertuar nga operatori ekonomik per zerin Siguria ne kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit tw shtuar), e perfshire ne oferten ekonomike te detajuar, konkretisht sipas Shtojces 2 te DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlere 1,187,174.18 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlere 1,187,174.18 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë vlere pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlere PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlere 1,187,174.18 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlloriten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlere më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlere së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlere e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

M_o – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (R_{rm}) – Rritje e mundshme

$M_o = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$

PR = 200 % M_o

Vlere e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlloritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK ($200\% MO = 51,500,000 \text{ leke} < 55,000,000 \text{ leke}$) dhe vleresohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlere per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.